REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Nr. ____ prot. Tepelenë, më ___/___2026

DETYRE PROJEKTIMIT

Objekti

"Përmirësim gjendjes banesave ekzistuese",Bashkia Tepelenë-Banesa 12/10 dhe

I-TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Nga Bashkia Tepelenë është hartuar programi për rikonstruksionin e mirëmbajtjen e banesave në qytet për përmirësim e kushteve të jetesës së banorëve sipas parametrave në fuqi.

Objektet ku do të ndërhyet për rikonstruksion dhe mirëmbajtje janë:

a. **Rikonstruksioni i Çatisë banesa 2K me nr.kadastral 12/10**
b. **Rikonstruksioni i Çatisë banesa 2K me nr.kadastral 12/13**

Fondi 2,083,333 leke pa tvsh dhe 2,500,000.00 lekë me TVSH

II-GJËNDJA EKZISTUESE

Nga verifikimet dhe inspektimet e kryera në terren është konstatuar se çatitë e ndërtesave të sipër përmendura janë **plotësisht të amortizuara** dhe kanë humbur funksionin e tyre mbrojtës dhe konkretisht:.

a. Banesa 2K me nr.kadastral 12/10 ka dimensione **14.85x10.77m=159.9m2** ka probleme me catinë .

b. Banesa 2K me nr.kadastral 12/10 ka dimensione **24.35x10.77m=159.9m2** ka probleme me catinë .

Problematikat kryesore të konstatuara janë:

- amortizim i plotë i mbulesës së çatisë;
- dëmtime të elementëve mbajtës të konstruksionit;
- depërtim i ujërave atmosferike në ambientet e brendshme;
- dëmtim i ulluqeve dhe elementëve të shkarkimit të ujërave;
- rrezik për përkeqësimin e mëtejshëm të ndërtesave dhe cenim të kushteve normale të përdorimit.

Për rrjedhojë,shkalla e lartë e amortizimit të cative bën të domosdoshëm përmirësimin e funksionimit të tyre në përgjithësi,duke synuar përafrimin e shërbimeve që ofrohen me standardet në fuqi.

Për shkak të gjendjes së rënduar teknike, ndërhyrjet e pjesshme nuk sigurojnë zgjidhje afatgjatë, ndaj është i domosdoshëm rikonstruksioni i plotë i çative.

Razije Naipi

Digitally signed by Razije Naipi
Date: 2026.08.13 13:26:24 +02'00'

III. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJES

Punimet që do të realizohen konsistojnë në:

- çmontimin e çative ekzistuese;
- riparimin dhe përforcimin e strukturës mbajtëse;
- vendosjen e membranës hidroizoluese;
- mbulimin me tjegulla të reja;
- furnizimin dhe montimin e aksesorëve përkatës;
- ndërtimin e ulluqeve të rinj;
- kryerjen e punimeve përfundimtare dhe pastrimin e kantierit.

III-OBJEKTIVI, QËLLIMI DHE REZULTATET QË PRITEN

1-Objektivi

Objektivi kryesor i Bashkisë Tepelenë është *Përmirësim gjendjes banesave ekzistuese",Bashkia Tepelenë*

Në lidhje me realizimin e këtij objektivi Bashkia Tepelenë kërkon hartimin e Projekt Preventivit të zbatimit me objekt*: "Përmirësim gjendjes banesave ekzistuese",Bashkia Tepelenë*

2-Qëllimi

Qëllimi kryesor i projektit të zbatimit është përmirësimi i gjendjes ekzistuese të banesave me kushtet normale të funksionimit të tyre.

Ky relacion hartohet për të argumentuar domosdoshmërinë e realizimit të investimit për rikonstruksionin e çative të ndërtesave të ndodhura në rrugën **"Batalioni Baba Abaz"**, të identifikuara në planin e rilevimit si **Pasuria nr. 12/10** dhe **Pasuria nr. 12/13**, me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit, garantimin e sigurisë së objekteve dhe ruajtjen e vlerës së tyre.

a. Kërkesa arkitektonike e konstruktive të objektit

Arkitektura e objektit nga jashtë do te ruhet ekzistuesja.

b. Standardet

Për projektimin e këtij objekti duhet të përdoren standardet shtetërore në fuqi për funksionin që kërkohet të përmbajë.

IV-Dokumentacioni për Projekt Preventivin e zbatimit duhet të përfshijë :

1. Vizatimet teknike
2. Relacioni teknik
3. Preventivi i zbatimit sipas manualeve në fuqi
4. Grafiku i punimeve
5. Specifikime Teknike

1- Vizatimet teknike duhet të përfshijë këto fletë :

- Planvendosje e përgjithshme e objektit;
- Planimetri e dimensionimit;
- Fotografi të gjendjes ekzistuese;

Projekt Preventivi do të hartohet në 3(tre) kopje origjinale dhe në **CD**

PËRGATITI

DREJTORIA E URBANISTIKËS

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE TE 2 BANESAVE

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE TE 2 BANESAVE

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE TE 2 BANESAVE